



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:020604

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05529169

KF.nr.127/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “BB Home NEW” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810021692 dhe seli në Mitrovicë, rr. “Shtypshkronja” p.nr., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.B. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e përsëritshëm të vendimit të ATK-së nr.507/2019 të datës 12.12.2019, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik me datë 08.02.2024, të mbajtur në prani të avokatit të palës paditëse N.B., e në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “BB Home NEW” Sh.P.K me seli në Mitrovicë, si e pabazuar.
- II. Mbetet në fuqi Vendimi nr. 507/2019 të datës 12.12.2019 i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 10.02.2020, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin a vendimit nr.507/2019 të datës 12.12.2019, me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit me nr.507/2019 e datës 07.11.2019 kundër Raport të kontrollit Ref.nr. AU2900000004074 të datës 26.10.2019. Përfaqësuesi i palës paditëse si në padi dhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor të datës 08.02.2024, ka deklaruar se edhe më tej qëndrojnë pranë

padisë, gjithashtu e bëjnë precizimin e petitumit të padisë ashtu që kërkojnë që gjykata të anulojë pjesërisht vendimin e atakuar dhe atë për pjesën e shumës financiare prej 41.000 Euro, e cila sipas raportit të kontrollit është kategorizuar si e hyrë dhe e cila edhe në procedurë të ankesës është miratuar nga Komisioni i Ankesave nga ATK. Më tej deklaroi se paditësja ka ofruar prova të mjaftueshme gjykatës me të cilat tregon se shumën për të cilën subjekti tatimor apo subjekti i kontrollit i cili evidenton si e hyrë, në bazë të provave e argumenton të kundërtën, ngase edhe raporti bankar është dëshmi që tregon se mjetet financiare prej 41.000 Euro kanë qarkulluar në mes të subjektit tatimor dhe kompanisë Eldaard N.T.Sh., në të cilën subjekti i kontrollit është aksionar në këtë kompani. Ka theksuar se shqetësimet e paditësit konsistojnë në faktin se në të njëjtën periudhë të kontrollit, ATK-ja evidenton lëvizje të mjeteve të të njëjtës kategori nga llogaria e paditësit të kompania Eldaard N.T.Sh., e të cilat raporti i kontrollit i evidenton, megjithatë merren vetëm si huazime dhe nuk i konsideron si të hyra ashtu siç pretendohet për shumën 41.000 Euro, ndërsa sa për ilustrim gjykatës i ka propozuar ti referohet faturave të datave 13.04.2017, 13.04.2018, dhe 23.04.2018 nga ku shihet kthimi i mjeteve nga subjekti tatimor nga kompania bashkëpunuese Eldaard N.T.Sh., e të cilat nuk i konsideron si të hyra, prandaj paditësi konsideron se ATK ka bërë aplikimin e standardeve të dyfishta gjatë kontrollit për faktin se sipas ligjit pavarësisht vlerës të gjitha kategoritë do të duhej të trajtoheshin njëjtë pavarësisht vlerës, qarkullimit në llogarinë bankare. Tutje ka theksuar se raporti i kontrollit dhe vendimi i Komisionit të ankesave në ATK janë nxjerrë në kundërshtim me ligjin e aplikueshme duke mos i marrë parasysh provat dhe argumentet e paditësit, mirëpo ka vendos në një mënyrë paushallë e cila konstatohet edhe nga vet deklarata e inspektorit tatimor i cili përveç deklarimit nuk ka arrit të dëshmojë se në cilën kategori saktë sipas ligjit bie shuma financiare prej 41.000 Euro dhe në bazë të vlerësimit të tij personal këtë shumë e kategorizon si të hyrë. Më tej i është referuar edhe praktikës gjyqësore të kësaj gjykate ku në raste të ngjashme është trajtuar me kontrollin e ATK-së qarkullimi i mjeteve dhe kategorizimi i tyre si të hyra e që sipas aktgjykimit A.nr.8/14 i datës 14.12.2019 ishte aprovuar kërkesëpadija e paditësit duke anuluar pjesërisht vendimin e ATK-së dhe ishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje e që shkaqet dhe arsyet janë të përshkruara me detaje në këtë aktgjykim. Në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës që nga provat e paraqitura dhe argumenteve ligjore të aprovojë kërkesëpadinë si të bazuar në ligj ashtu që të anulohet vendimi i atakuar, sipas precizimit të bërë në këtë seancë ose në mënyrë alternative ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit dhe lënda të kthehet në rishqyrtim.

E paditura, në përgjigje në padi të datës 28.04.2021 ka deklaruar se bazuar në datën e vendimit padia është ushtruar jashtë afatit ligjor. Tutje ka deklaruar se Administrata Tatimore e

Kosovës i kundërshton pretendimet e paditësit, si të pabazuar në ligj dhe faktet materiale dhe kanë vlerësuar se vendimi kontestuese i Divizionit të Ankesave është i drejtë dhe në harmoni të plotë me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, me arsyetim se nuk është dëshmuar se janë anuluar faturat e blerjes dhe është kthyer malli i blerë, siç kërkohet në dispozitat ligjore të nenit 47 të Ligjit Nr.05/L-037 Për Tatim mbi Vlerën e Shtuar dhe neni 65 i UA Nr.03/2015, gjithashtu thekson se nuk dëshmohet me dokumentacion burimor të trajtohet si huadhënie të përcaktuar në nenin 7 paragrafi 3.2 të UA Nr.02/2016 për zbatimin e Ligjit Nr.05/L029 “Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave” ku në nenin 3.1.3 të UA thuhet *“Pranimi-kthimi i huas duhet të bëhet përmes llogarisë bankare”*, ndërsa shumë qartë në nenin 3.2. të këtij udhëzimi thuhet *“Nëse nuk plotësohen kushtet e parapara në nën paragrafin 3.1. të këtij neni, huaja për qëllime tatimore trajtohet e ardhur për pranuesin e saj”*. Më tej në parashtrësën e datës 06.02.2024 i ka kërkuar gjykatës që të veprojë në pajtim me nenin 38 paragrafi 5 të Ligjit nr.03L-202 për Konfliktin Administrativ, citon *“Gjykata mund të vendos çështjen pa shqyrtim verbal, nëse ka fakte të mjaftueshme dhe kur palët kanë dhënë pëlqimin e tyre në formë të shkruar”*. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzojë padinë/ankesën e paditësit si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi nr.507/2019 i datës 12.12.2019 i Administratës Tatimore të Kosovës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 08.02.2024, ka administruar provat dhe atë: Vendimi i ATK-së nr.507/2019 i datës 12.12.2019, qarkullimi bankar për periudhën 01.01.2017 - 31.12.2018, faturat tatimore të datës 27.07.2017, 16.10.2017, dhe 09.11.2017, letër konfirmimi të datës 17.10.2019, përgjigjja në padi e datës 28.04.2021, raporti i kontrollit i datës 26.10.2019, analizë e bankave NLB, BPB vitit 2017-2018, kartelë e furnitorit e datës 31.12.2018, ankesë ndaj raportit të kontrollit e datës 06.11.2019, dhe pasqyrë e tatim paguesit e datës 27.04.2021.

Me qëllim të vlerësimit të pretendimeve të të paditurës lidhur me afatshmërinë e padisë, gjykata ka rihapur seancën e shqyrtimit kryesor, megjithatë asnjëra nga palët ndrëgjyqëse nuk ka prezantuar. Gjykata ka kërkuar nga e paditura që të ofrojë dëshminë për pranimin e vendimit kontestues nga paditësi, mirëpo nga e njëjta është informuar se nuk e posedon të njëjtën dhe se duhet të kërkojë nga paditësi këtë informatë. Si rrjedhojë, gjykata padinë e vlerësoi si të afatshme në mungesë të dëshmisë nga e paditura, të cilës edhe i takon barra e provës për një pretendim të tillë.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Gjykata nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga Raport kontrolli i ATK-së, deklarimeve në ankesë, si dhe aktvendimi kontestues ka nxjerr konstatimin se paditësi -subjekti ekonomik BB Home i është nënshtruar kontrollës nga e paditura, kontrolli është kryer për periudhën TVSH prej 04/2017-12/2018, CD për vitet 2017-2018, WM për vitet 04/2017-12-2018 dhe CM për vitet 04/2017-12-2018, dhe si rezultat i parregullsive në kontroll ka rezultuar tatim shtesë për TVSH në vlerë prej 3,077.05 €, zvogëlim i kreditimit 9,293.2 €, për CD tatim shtesë në vlerë prej 8,864.8€ dhe WR tatim shtesë në vlerë prej 648.00€. Tatimpaguesi i pakënaqur me rezultatet e kontrollit të kryera nga ATK-ja ka ushtruar ankesë në Departamentin e ankesave ndaj njoftimit rivlerësim të ATK-se. Pas shqyrtimit të ankesës nga Departamenti ankesave me vendimin kontestues, e paditura ka refuzuar si të pabazuar ankesën e tatimpaguesit. Në arsyetimin e vendimit kontestues e paditura thekson se kontrolli vlerësimin e ka mbështet në nenin 13, 14 dhe 15 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimor dhe Procedurat si dhe nenin 17 të Udhëzimit Administrativ 15/2010, me ç'rast tatimpaguesi është obliguar me tatim shtesë. Ndaj vendimit të DA-ATK, paditësi me padi ka iniciuar këtë konflikt administrativ.

Kontestuese në mes të palëve mbetet nëse transaksioni financiar në shumë prej 41.000 Euro është trajtuar drejtë nga e paditura, si e hyrë.

Gjykata pas elaborimit të arsyetimit të vendimit kontestues, thëniet të palëve dhe provave të cilat gjenden në shkresat të lëndës, konstaton se, me vendimin e kontestuar e paditura ka konstatuar se vlerësimin e kontrollit e ka marrë të besueshëm pasi është vërtetuar gjendja e tatimpaguesit duke marrë për bazë llogarinë bankare, transaksionin bankarë prej 41,000.00 euro i cili nuk ka të dhëna në përshkrim të transaksionit se është kthim i mjeteve nga furnitori NTSH "Eldaard", nuk dëshmohet se janë anuluar faturat e blerjes dhe është kthyer mali i blerë siç kërkohet me dispozitën ligjore të nenit 47 të Ligjit Nr.05/L-037 Për tatimin mbi vlerën e Shtuar dhe neni 65 i UA nr.03/2015. Gjithashtu nuk dëshmohet me dokumentacionin burimor të

trajtohet si huadhënie të përcaktuar sipas nenit 7 paragrafi 3.2 i UA nr.02/2016 për zbatimin e Ligjit NR.05/l-029 “Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatavee”.

Nga raporti i kontrollit konstatohet se pas analizimit të llogarive bankare është konstatuar se me datë 04.07.2018 tatimpaguesi ka pranuar në llogarinë bankare të NLB mjete në vlerë prej 41,000 euro nga njëri prej aksionareve “Eldaard”, ku përshkrimin në transaksion e ka regjistrimi i rrogave në llogari rrjedhëse pa dhënë dëshmi sa a është shtim i kapitalit apo pagesë për konsideratë, ndërsa tutje konstaton se siç shihet këto mjete janë përdorur për qëllim të pagesës së taksës komunale për objektin C4.

Nga kjo gjendje e fakteve, gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe raportin e kontrollit dhe se dëshmitë e paraqitura nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Gjykata pretendimet e paditësit se e paditura evidenton lëvizje të mjeteve të të njëjtës kategori nga llogaria e paditësit te kompania Eldaard N.T.Sh., e të cilat raporti i kontrollit i evidenton, megjithatë merren vetëm si huazime dhe nuk i konsideron si të hyra ashtu siç pretendohet për shumën 41.000 Euro, ndërsa sa për ilustrim gjykatës i ka propozuar ti referohet faturave të datave 13.04.2017, 13.04.2018, dhe 23.04.2018 nga ku shihet kthimi i mjeteve nga subjekti tatimor nga kompania bashkëpunuese Eldaard N.T.Sh., e të cilat nuk i konsideron si të hyra, prandaj paditësi konsideron se ATK ka bërë aplikimin e standardeve të dyfishta gjate kontrollit për faktin se sipas ligjit pavarësisht vlerës të gjitha kategoritë do të duhej të trajtoheshin njëjtë pavarësisht vlerës dhe qarkullimit në llogarinë bankare, i vlerësoj të pabazuara.

Paditësi as në procedurë administrative tek e paditura por as në këtë gjykatë, nuk ka arritur që të paraqes dëshmi konkrete dhe prova të besueshme se transaksioni bankar në shumë prej 41,000.00 euro i trajtuar me kontroll si e hyrë për biznesin nuk e kanë burimin nga të ardhurat e tatueshme. Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se vlerësimi i ATK-së është bazuar në provat në dispozicion dhe dispozitat ligjore të aplikueshme përkatësisht neni 19.2 i Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Gjykata vlerëson se e paditura me të drejtë i ka trajtuar transaksionin bankar të pa argumentuara si qarkullim shtesë, në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 19.2 të Ligjit nr.03/L-222, sepse burimet kanë qenë nga njëri prej aksionarëve të paditësit, por të cilat janë realizuar pa përshkrim dhe se të njëjtat nuk kanë mundur të konsiderohen as kthime të pagesave e as huazime, ashtu siç edhe me të drejtë e ka arsyetuar e paditura.

Pretendimet e paditësit se kthimi i mjeteve nga subjekti Eldaard është i evidentuar në kartelën e furnitorit, gjykata e vlerësoi si të pabazuar kjo për faktin se kartela e furnitorit nuk mund të ndikon në një vendim ndryshe, andaj edhe e vlerësoi si provë të pamjaftueshme.

Me nenin 47 të Ligjit nr. 05/L -037 për tatimin mbi vlerën e shtuar, është përcaktuar se “ 1. Kur shuma e tatueshme dhe TVSH-ja në faturën tatimore duhet të korrigjohet në pajtueshmëri me nenin 41 të këtij ligji, furnizuesi duhet të lëshojë një notë debiti apo një notë krediti dhe duhet të trajtojë atë notë sikur të ishte faturë tatimore. 2. Notë debiti dhe notë krediti duhet së paku të përmbajnë informatat si në vijim: 2.1. datën e lëshimit; 2.2. numrin rendor; 2.3. referencën në faturën origjinale; 2.4. identifikimin e furnizuesit dhe të blerësit, emrin, adresën dhe numrat e tyre fiskal, dhe nëse është e aplikueshme, numrat e tyre të regjistrimit të TVSH-së; 2.5. arsyen e korrigjimit, dhe; 2.6. shumën e tatueshme të korrigjuar dhe TVSH-në e korrigjuar, ndërsa me nenin 65 të UA 3/2015 për zbatimin e ligjit 05/L -037 për tatimin mbi vlerën e shtuar, ndër të tjera në paragrafin e 6 është përcaktuar se “.Fatura “notë debiti” e lëshuar nga personi i tatueshëm duhet të regjistrohet nga furnizuesi në librin e shitjeve, e cila edhe do të rrisë obligimin për të paguar TVSH më tepër në krahasim me faturën e parë të lëshuar për të njëjtin transaksion. Ndërsa nga pranuesi i faturës, regjistrimi bëhet në librin e blerjes duke rritur TVSH-në e zbritshme.”

Në mungesë të provave të cilat do të dëshmonin aplikimin e drejtë të dispozitave të lartcekura nga këtu paditësi, gjykata nuk mundi të vendos ndryshe nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.

Prandaj, në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe vlerësimit të provave, gjykata konstaton se vendimi i Departamentit të Ankesave të ATK-së me nr. 507/2019 të datës 12.12.2019 është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës si në pikën III të këtij aktgjykimi, Gjykata e mori konform nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga të lartcekurat, gjykata konform dispozitat ligjore të nenit 81.I paragrafi 2 pik a2.1 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.127/22, datë 21.03.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.